

L I G J
Nr.7900, datë 8.2.1995

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7758, DATË 12.10.1993 “PËR DOKUMENTIMIN
DHE MBAJTJEN E LLOGARIVE PËR TATIMET”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7758, datë 12.10.1993, në fillim të paragrafit të dytë të nenit 4, pas fjalës “numrin” shtohen fjalët “rendor dhe numrin e certifikatës së ushtrimit të veprimtarisë”.

Neni 2

Në paragrafin e dytë të nenit 5 fjala “çmimin” të zëvendësohet me fjalën “vlerën”.

Neni 3

Në fund të paragrafit të parë të nenit 8 shtohet fjalia “Blerësi për çdo rast të tillë shënon në faturë edhe numrin e certifikatës së tij të ushtrimit të veprimtarisë”.

Neni 4

Në nenin 10, pas fjalëve “të hapura për publikun”, shtohen fjalët “dhe për çdo klient tjetër”.

Neni 5

Neni 14 ndryshohet si vijon:

“Shkeljet e dispozitave të këtij ligji për vendosjen dhe përdorimin e arkave regjistruese, për lëshimin e kuponave tatimore dhe ruajtjen e tyre, dënohen si vijon:

a) Personat fizikë a juridikë që, duke qenë të detyruar, nuk vendosin në lokalet ose njësitë e tyre arkat regjistruese, organi i administratës tatimore vendos pezullimin e certifikatës për ushtrimin e veprimtarisë në lokalet ose njësitë e tyre, deri në momentin e pajisjes me arkë regjistreuse.

Ky sanksion zbatohet edhe për rastet kur në lokale a njësi të tjera vihen në përdorim aparate të ndryshme nga ato që janë miratuar.

b) Ata që, duke qenë të detyruar, nuk lëshojnë kuponin tatimor ose e lëshojnë atë me vlerë më të vogël se vlera reale, dënohen me gjobë si më poshtë:

- Kur shkelja bëhet për herë të parë, me dhjetë mijë lekë.

- Kur shkelja përsëritet për herë të dytë, me pesëdhjetë mijë lekë.

Në rast se gjatë dymbëdhjetë muajve të njëpasnjëshëm numri i shkeljeve të vërtetuara sipas pikës “b” të mësipërme për moslëshimin e kuponit apo të regjistrimit të një shume më të vogël se ajo reale është më shumë se dy herë, organi i administratës tatimore zbaton edhe masën e pezullimit të certifikatës së ushtrimit të veprimtarisë për një periudhë jo më pak se tridhjetë ditë dhe jo më shumë se gjashtëdhjetë ditë.

c) Kur nuk njofton menjëherë se arka regjistruese ka pësuar defekt dhe nuk plotëson në rregull librezën fiskale të defekteve, subjekti përdorues i arkës regjistruese dënohet me gjobë dhjetë mijë lekë.

d) Kur nuk plotëson në rregull regjistrin e llogarive për mbylljet ditore dhe mujore, nuk paraqet në degën e tatimeve mbylljen mujore, nuk ruan mbylljet ditore dhe rulonat e regjistruar të

letrës në dosjen e kuponave, përdoruesi i arkës regjistruese dënohet me gjobë dhjetë mijë lekë.

e) Mosrespektimi nga ndërmarrja e autorizuar prej Ministrisë së Financave i afateve të përcaktuara me udhëzim të veçantë të kësaj të fundit për vendosjen e arkave regjistruese, riparimin e defekteve dhe kryerjen e vizitës fiskale, dënohet me gjobë dhjetë mijë lekë për çdo 24 orë vonesë në çdo rast.

f) Mosmarrja nga blerësi e kuponit tatimor dënohet me gjobë një mijë lekë.

Konstatimi, shqyrtimi dhe dënimi i shkeljeve të parashikuara në pikat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f” të këtij neni bëhet nga organet tatimore dhe të policisë financiare të juridiksionit ku subjekti ushtron veprimtarinë ose kryen shkeljen.

Neni 6

Pas nenit 15 shtohet neni 15/1 me këtë përmbajtje:

“Të gjitha gjobat e vendosura lidhur me përdorimin e arkave regjistruese, do të përfshihen në të ardhurat respektive tatimore, në varësi nga lloji i subjektit përdorues të arkës regjistruese (person fizik a juridik) dhe me natyrën e tatimit (tatim mbi biznesin e vogël ose tatim mbi qarkullimin)”.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1024, datë 20.2.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha